

Më  
Dana

28-09-2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:015283

Datë: 04.09.2018

Numri i dokumentit: 00113310

P.nr.2207/2017

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Mimoza Shabani, bashkëpunëtore profesionale, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga [REDACTED] Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm PP/IL.nr.1391-3/17 të dt.05.09.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarës [REDACTED] si dhe të pandehurit [REDACTED] me avokaten mbrojtëse [REDACTED], me datë 13.08.2018 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 20.08.2018, përpiloi me shkrim këtë:

## AKTGJYKIM

I pandehuri: [REDACTED] i lindur me [REDACTED], nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] ka të kryer shkollën fillore, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal [REDACTED]

## ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më dt. 05.01.2017, rreth orës 17:20, në rrugën "Ismet Jashari" në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e tipit "Mercedes", ngjyrë vishnje, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe të pasurisë, ashtu që në kundërshtim me nenin 53 par. 1 të ligjit mbi trafikun publik, nuk e përshtata shpejtësinë e lëvizjes kushteve të lëvizjes në rrugë, e cila ishte e mbuluar me borë, për pasojë me pjesën e përparme të anës së majtë e godet këmbësoren - të dëmtuarën [REDAKTUAR], me ç'rast nga goditja e njëjta pëson ndrydhje të indeve të buta të nyjës kërdhokullës të kofshës së këmbës së djathtë të cilat lëndime bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me ndikim të përkohshëm për shëndetin.

me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,49,50,51,52,73, nenit 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453,463, të KPPRK-së,

## G J Y K O N

### D Ë N I M M E K U S H T

Të pandehurin [REDAKTUAR], e dënon me dënim me burgim prej 6 (gjashtë) Muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale.

E dëmtuar [REDAKTUAR] me vendbanim në Ferizaj, Rr. [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzetë/ si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumën prej 60.88 Euro /gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent), në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1931-3/17 dt. 05.09.2017, ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, për veprën penale rrezikim i trefikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.08.2018 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari [REDAKTUAR] e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë aksident, i kërkon falje publike të dëmtuares, është hera e parë që ndeshet me ligjin, premtion gjykatës që në të ardhmen do të shtoj kujdesin në komunikacion, dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë.*

Mbrojtës i të pandehuri [REDAKTUAR] Av. [REDAKTUAR] në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: e mbështes pranimin e fajësisë, pranim ky i cili është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshme me mua si mbrojtëse e tij dhe në lidhje me këtë i propozoj gjykatës që ta pranoj këtë pranim të fajësisë të sjellur nga klienti im, klienti im është në gjendje të rëndë shëndetësore, në moshë të shtyre, vuan nga sëmundjet e zemrës si dhe disa sëmundje të tjera të moshës të cilat evidentohen më së mirë në raportet mjekësore, i propozoj gjykatës që me rastin e matjes së dënimit të aplikoj dispozitat e nenit 75-76 të KPRK-së, sepse vepra është kryer nga pakujdesia dhe kushteve të vështira ekonomike.

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënimin e merituar.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;

pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht: ekspertiza e mjekut ligjor dt.07.08.2017, ekspertiza e komunikacionit 10.08.2017, raporti i aksidentit me nr. 2017-CFT-153 i dt.05.01.2017, deklarata e të pandehurit e dt.05.01.2017, deklarata e të dëmtuarës e dt.23.03.2017, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës;

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.
- me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: më dt. 05.01.2017, rreth orës 17:20, në rrugën "Ismet Jashari" në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e tipit "Mercedes", ngjyrë vishnje, me targa të regjistrimit ■■■■■ ■■■■■ nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe të pasurisë, ashtu që në kundërshtim me nenin 53 par. 1 të ligjit mbi trafikun publik, nuk e përshtata shpejtësinë e lëvizjes kushteve të lëvizjes në rrugë, e cila ishte e mbuluar me borë, për pasojë me pjesën e përparme të anës së majtë e godet këmbësoren - të dëmtuarën ■■■■■, me ç'rast nga goditja e njëjta pëson ndrydhje të indeve të buta të njëjës kërdhokullës të kofshës së këmbës së djathtë të cilat lëndime bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me ndikim të përkohshëm për shëndetin.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikimi i trafikut nga neni 378 par 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk është vërtetuar se ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, e që këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat personale si moshën e shtyre, i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, P.nr.2207/17 datë 20.08.2018.**

Zyrtare ligjore

Mimoza Shabani

Gjyqtari: Ilir Bytyqi



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.